

FJALA E DEPUTETES ANILA DENAJ

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë, Si çdo vit buxheti markohet me një titull që përcaktohet nga prioritet në të cilat fokusohet shpërndarja e shpenzimeve buxhetore, si ato kapitale dhe korrente, me një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve buxhetore në mbështetjeve të politikave shëndetësore dhe sociale për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjen Sociale, ku për herë të parë në vitin 2022 realizohet një normë prej 4, 89% ndaj PBB-së. Mendojmë se me të drejtë projekt buxhetit mund t'i atribuohet titulli: "Ruajtja e jetës së qytetarëve dhe mbështetjes sociale". Vioj me listën e projekteve në infrastrukturë, ku një pjesë e rëndësishme e të cilave janë në fazën e finalizimit, siç janë Rruga e Arbrit apo përfundimi i rrugës Kardhiq – Delvinë, dhe të tjera janë në nisje si projekte jo të reja por, pa dyshim, fillime punimesh për herë të parë. Projekti më i fundit është nisur ditën e djeshme me fillimin e punimeve në tunelin e Llogorasë, fillimi i të cilave u inaugurua edhe në prezencë të Kryeministrit Rama. Janë investimet në segmentin Elbasan– Përrenjas– Qafë Thanë dhe bajpasi i Shkodrës. Është hapja e procedurave të porteve të Durrësit dhe Vlorës dhe të aeroporteve të Vlorës dhe Sarandës. Janë linjat e reja hekurudhore TiranëDurrës dhe Tiranë – Rinas, sigurisht, pa harruar asnjë moment Unazën e Tiranës që na shoqëron në përditshmërinë tonë. Me këto projekte nuk ke si të mos mendosh se ky është buxheti i konektivitetit dhe i zhvillimit ekonomik, në veçanti i atyre të zonave rurale dhe turistike. Megjithatë konektiviteti digjital nuk është më pak në fokus të politikave me mbështetje buxhetore në buxhetin e vitit 2022, në veçanti për përmirësimin e shërbimeve publike, të cilat nuk fillojnë sot dhe jo rastësisht Shqipëria mban vendin e parë në rajon për shërbime të digjitalizuara, por, mbi të gjitha, në formatin dhe në mendësinë ku investimet në digjitalizim në këtë projektbuxhet shkojnë përtej investimeve në shërbimet publike, si: në edukimin e të rinjve; në mbështetjen e sipërmarrjes, duke filluar nga ato të start-up për inovacion për të siguruar jo vetëm vende pune, por, mbi të gjitha, vende pune cilësore, ato që tregu i punës sot i kërkon me domosdoshmëri. Nuk parashikohen vetëm në sektorët e rendit, mbrojtjes, shëndetësisë, financave dhe arsimit.

Nuk mund të rri pa përmendur garancinë e dedikuar prej 1 miliard lekësh për manufakturën në sipërmarrje, si një mbështetje jo vetëm për tejkalimin e vështirësive të pandemisë, por, mbi të gjitha, për strukturat e reja që biznesi ka nevojë në këtë kohë për të digjitalizuar edhe ai mënyrën e të bërit biznes drejt të ardhmes së sigurt. Sot 63% e të punësuarave janë të kategorizuar me paga deri në 40 mijë lekë të rinj. Sigurisht, lajmi që tatimi mbi këto paga do të jetë zero, është një lajm i mirë për 63% të të gjithë shqiptarëve që janë të punësuar në këtë fashë, sikurse edhe lehtësimi i barrës nga 23% në 13% për një kategori tjetër të shtresës së mesme, me ndryshimin e kufirit nga 150 deri në 200 mijë lekë. Mbi të gjitha, sfida nuk është vetëm ulja e barrës fiskale që, sigurisht, është para në xhepat e të gjithë këtyre punonjësve, të cilët do t'i çojnë në konsum, mbi të gjitha, sfidë është rritja e cilësisë së punës dhe rritja e formalizimit në tregun e punës. Bujqësia mbetet në fokus si një sektor i rëndësishëm si për peshën specifike, por, mbi të gjitha, për mënyrën se si do të mbështetet fermeri. Nuk dua të përsëris as ministren dhe asnjë nga parafolësit, por është e sigurt që paketa fiskale nuk mund të jetë ombrellë e nxitjes në bujqësi, por subvencionet dhe mbështetja me skemat po. Mbështetjen me

skemat i prezantuar vitin e kaluar dhe sivjet jemi të gjithë dëshmitarë të mbështetjes me skemën shtesë për fermerët për rimbursimin e naftës dhe fondin e shtuar, i cili në total shkon 12,7 miliardë lekë për fermerët për të subvencionuar ata sektorë të rëndësishëm, të cilët ekonomia i ka të nevojshëm jo vetëm në këtë moment, por gjithmonë. Në sektorin e turizmit nuk mundësohet vetëm një fokus dhe vëmendje drejt pastrimit, por, mbi të gjitha, një garanci sovranë me 1 miliard lekë dhe 500 milionë lekë për buxhetet e bashkive, që u përmendën pak më parë. E gjitha shkon për të përmirësuar jo vetëm strukturën e bizneseve, por për ta çuar turizmin në një turizëm cilësor dhe elitari. Investimet në infrastrukturën artistike, e përmendi pak më parë edhe ministrja, janë trefishuar nga një vit në tjetrin dhe janë jo vetëm në infrastrukturë, por, mbi të gjitha, në atë që është vlera jonë kombëtare dhe artistike.

Buxheti i vitit 2022 parashikon shpenzimet për pagesën e papunësisë me 900 milionë lekë, për pagesën e aftësisë së kufizuar me 23,5 miliardë lekë dhe për ish-të përndjekurit me një fond prej 1 miliard lekësh. Do të vijojë skema e librave shkollorë falas për nxënësit nga shtresat në nevojë dhe do të sigurohet, gjithashtu, transporti për nxënësit dhe mësuesit që banojnë larg nga shkolla. Ka një element po aq të rëndësishëm, që nuk përmendet zakonisht në formatet e diskutimeve mes të dy përfaqësuesve politikë, shifra e barazisë gjinore është tregues shumë i rëndësishëm i mënyrës se si buxhetet përfshijnë edhe atë që ndoshta është një nga ngërçet kryesore në zhvillimin ekonomik. Në buxhetin e vitit 2022 janë parashikuar 47 programe në mbështetje të barazisë gjinore, nga 9 që ishin në vitin 2013. Buxheti i këtyre programeve shkon në 9% ndaj totalit të buxhetit nga 1% në 2015. Sigurisht, kjo vlen për t'iu ardhur në ndihmë të gjitha diskutimeve, të cilat vendosin në fokus barazinë gjinore për t'i dhënë fuqi ekonomisë dhe gruas. Duke përmendur të gjitha këto dhe shumë të tjera që mund të kem lënë pa thënë, por për arsye të kohës kam nevojë që të mos i përsëris, pasi ministrja i tha pak më parë, besoj se vërtet ky është një projektbuxhet, titulli i të cilit është "Për qytetarët dhe zhvillimin ekonomik", ku 34,1% e PBB-së shkon për shpenzime si asnjëherë më parë, të cilat ndihmojnë ekonominë dhe punësimin. Megjithatë, mbeten sfida. Në Komisionin e Ekonomisë kemi folur edhe me kolegët e Partisë Demokratike, sipas të cilëve ne e pikturonim gjithçka rozë. Jo, ne nuk i kemi lënë pa përmendur edhe sfidat, edhe problematikat, vetëm që dimë t'i vendosim në perspektivë dhe, duke e bërë këtë, të punojmë e t'ia dalim.

Sfidat janë në raport me strukturën ekonomike, me politikat ekonomike, por, njëkohësisht, me formalizimin e ekonomisë. Jemi duke punuar dhe kemi ende rrugë për të bërë drejt rritjes së të ardhurave mbi PBB-në në synimin që kemi, pra 31%, sepse vetëm kështu do të sigurojmë edhe mbështetjen për rritjen e pagave, më shpejt se sa kemi menduar, por, njëkohësisht, edhe konsolidimin fiskal. Reforma në kadastër dhe ndërlidhja e saj me të ardhurat fiskale në afatmesëm kërkojnë shërbime të digjitalizuara, por edhe mbështetje buxhetore. Një sfidë tjetër po aq e rëndësishme është rritja dhe forcimi i institucioneve dhe, mbi të gjitha, përmirësimi i imazhit të tyre në luftën ndaj korrupsionit, ndaj edhe bota digjitale është një ndihmë e padiskutueshme drejt këtij synimi. Dalja nga lista gri dhe realizimi me sukses i reformës në drejtësi janë parakushtet bazë të ambicies së të gjithëve ne, por edhe të çdo shqiptari drejt rrugëtimit të vetëm, atij të integritit evropian. Të gjitha këto janë të pasqyruara në këtë buxhet, ndaj, pavarësisht ndasive, unë besoj se, kush lexon shifrat dhe ka objektivin që këto shifra t'i sjellë sa më afër vendimmarrjes së tij, ta marrë sot vendimin pozitiv. Ju faleminderit!